



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*

**KABINETI I MINISTRES PËR DIALOGUN EDITA TAHIRI**

---

**Për Qeverinë e Republikës së Kosovës**

# Raporti 100 ditor i Ministres për Dialogun

**Prishtinë, 20 mars 2015**

## **Raporti 100 ditor i Ministres për Dialogun**

Në pajtim me Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministria për Dialogun dhe kabineti i sajë, kanë zhvilluar veprimtari intensive për të përmbushur përgjegjësitë dhe detyrat që janë në fushëveprimtarinë e Dialogut të Brukselit. Duke marrë parasysh nismën e punës së Qeverisë së re, angazhimet kanë qenë të fokusuar në hartimin e dokumenteve programore, Programin e Qeverisë për Dialogun e Brukselit për periudhën katërvjeçare, Planin Vjetor të punës dhe Matricën për programin e Qeverisë, si dhe inputet për Programin e Qeverisë 2015-2018. Të cilat janë dorëzuar në afatet e caktuara. Me qëllim të informimit të Qeverisë së re të Kosovës për ecurinë e dialogut të Brukselit, Ministria për dialog ka zhvilluar takime dhe ka paraqitur te KM dhe ZVKM/MPJ disa memorandume analitike dhe informuese për procesin si dhe dokumente tjera strategjike që kanë të bëjnë me temat vijuese.

Në kuadër të prioritetit strategjik numër 3. Agjenda evropiane dhe politika e jashtme, objektivi 3.5 Normalizimi i plotë i marrëdhënieve ndërshtetërore me Serbinë dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike dhe të mira fqinjësore në frymën evropiane (pika 3.5.1.9), gjatë periudhës 100 ditësh të punës, Ministria për dialog dhe kabineti i sajë kanë zhvilluar një veprimtari të fokusuar dhe intensive për të përmbushur këtë prioritet. Janë zhvilluar takime të niveleve të ndryshme me institucionet relevante qeveritare me qëllim të bashkërendimit të punëve rreth dialogut, janë hartuar dokumente strategjike për të çuar përpara interesat nacionale në Dialogun e Brukselit. Kemi zhvilluar një bashkëpunim të ngushtë me Bashkimin Evropian dhe SHBA-të rreth agjendës së dialogut përmes takimeve të drejtpërdrejta në Bruksel dhe Prishtinë dhe komunikimeve elektronike për të shkëmbyer mendimet dhe qëndrimet për zgjidhjet e mundshme në arritjen dhe zbatimin e Marrëveshjeve të dialogut të Brukselit. Bashkëpunimi i rregullt është mbajtur edhe me përfaqësuesit e BE-së në Kosovës dhe Ambasadën Amerikane në Prishtinë. Ministria po ashtu ka raportuar para Komisionit për politikë të jashtme të Kuvendit të Kosovës dhe ka marrë pjesë në debatet parlamentare gjatë seancave të Kuvendit.

Në periudhën e raportimit, Ministria për Dialogun ka marrë pjesë në disa raunde të bisedimeve në Bruksel dhe Prishtinë (15 dhjetor 2014, 8 dhe 26 janar, 4-6 shkurt, 25-26 shkurt, 18 mars 2013) ku janë trajtuar fushat si shuarja e strukturave paralele, energjia, sigurimi kufitar i automjeteve, licencimi i kompanive në veri të vendit, importi i medikamenteve, etj.

Takimi i datës 26 janar 2015 në Bruksel i ka shërbyer përgatitjes së takimit të parë të Kryeministrit Mustafa me BE/PL Mogherini dhe raundit të parë të dialogut të Kryeministrave të dy shteteve në përbërjen e re. Paraprakisht, Ministria për dialog më 8 shkurt 2015 ka përgatitur dhe dorëzuar në Qeveri, dokumentin mbi Strategjinë për negociim të Qeverisë së Kosovës. Takimi i nivelit të KM-ve dhe PL Mogherini, që u mbajt më 9-10 shkurt 2015, në të cilin mori pjesë edhe vetë Ministria dhe ministrat tjerë të linjës, rezultoi më Marrëveshjen për drejtësi. Kjo marrëveshje përmban planin konkret për zbatim për çështjet e drejtësisë që mundëson shtrirjen e sistemit unitar të drejtësisë në veri të vendit dhe integrimin e gjykatësve dhe prokurorëve serb, ndërkohë që shuarja e strukturave paralele të drejtësisë ka ndodhur në vitin 2013. Këto arritje të Qeverisë së Kosovës ndërlidhen edhe me përmbushjen e prioritetin strategjik numër 2, qeverisja e mirë dhe fuqizimi i sundimit të ligjit. Në këtë kuadër, kemi vazhduar angazhimet për shuarjen e të ashtuquajturës “mbrojta civile” dhe integrimin e individëve në institucione civile të Kosovës. Për këtë qëllim, në Prishtinë, janë zhvilluar tre takime të gjata e intensive me përfaqësuesit e BE-së (nëntor, shkurt dhe mars) dhe procesi ka avancuar drejtë finalizimit të marrëveshjes për zbatim. Pastaj më 17 mars 2015 Ministria ka diskutuar me sekretarët e përgjithshëm të Qeverisë për përgatitjen e planit të shtrirjes së institucioneve qendrore në komunat veriore të vendit dhe integrimin e individëve/ish pjesëtarëve të “Mbrojtjes civile”.

Në funksion të qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit, angazhime janë fokusuar po ashtu për funksionalizimit komunave legale në veri, në veçanti për miratimin e buxheteve legale nga këto komuna. Janë zhvilluar takime koordinuese me MF dhe MAPL dhe partnerët amerikan dhe evropian. Më 19 shkurt 2015, Ministria për dialog i ka shkruar letër BE-së për të kërkuar angazhimet e BE-së në zgjidhjen e këtij problemi, duke paralajmëruar rrezikun e bllokimit të financave për këto komuna sipas afatit më 1 mars 2015. Megjithatë komunat dështuan ti miratojnë buxhetet, të ndikuara nga Serbia dhe tendencat për mospërfshirjen e arsimit dhe shëndetësisë komunale në sistemin e Kosovës. Përpjekjet vazhdojnë për tejkalimin e problemit. Duke pasur parasysh rolin destruktiv të Serbisë dhe moszbatimin e marrëveshjeve nga ana e sajë, Ministria Tahiri ka kërkuar që BE të angazhohet për shuarjen e strukturave paralele serbe në Kosovë, duke theksuar se është pengesa kryesore për zbatimin efektiv të marrëveshjeve të Brukselit.

Më 25 Shkurt 2015 me ftesë të BE-së, ministrja Tahiri ka marrë pjesë në takimin strategjik në Bruksel ku me përfaqësuesit e Bashkimit Evropian është biseduar për mbarëvajtjen e procesit të dialogut dhe nevojën për shtimin e dinamikave për zbatimin e marrëveshjeve.

Lidhur me Marrëveshja e IBM -it, është punuar në shpejtimin e ndërtimit të ndërtesave të përhershme në gjashtë pikë kalimet kufitare (PKK) mes Kosovës dhe Serbisë. Krahas takimeve me BE-në në Bruksel dhe Prishtinë, më 9 mars 2015, Ministria i është drejtuar me letër BE-së ku është kërkuar përshejtimi i procesit.

Në çështjet e energjisë, si rezultat i marrëveshjes së Brukselit për energjinë, Kosova/KOSST është pranuar si bllok rregullues i mëvetëm nga ENTSO, që pritet të formalizohet deri në gjysmën e këtij viti. Po ashtu, kemi ndërhyrë në zhbllokimin e punës së Hidrocentralit të Ujmanit të ndaluar nga drejtori ilegal i sajë, përmes ndërmjetësimit të BE.

Çështja e migrimeve të parregullta në kuadër të bashkëpunimit ndër fqinjësor dhe rajonal i iniciuar nga BE, ka qenë po ashtu pjesë e angazhimeve të Ministres. Takimi në Bruksel për këtë çështje (25 shkurt 2015) me ndërmjetësim të Komisionit për Zgjerim të BE-së, ka sjellë rezultate konkrete, ndër tjerash, në dakordimet për bashkëpunim bilateral me Serbinë për kthimin e të qytetarëve që emigruan. Në fushën e lëvizjes së lirë, më 7 mars 2015, janë ndërmarrë veprime të zhbllokuar ndalesën e Serbisë ndaj autobusëve dhe kamionëve nga Kosova (Merdare dhe Dheu i Bardhë). Me intervenimin e BE-së problemi është evituar.

Sa i takon prioritetit strategjik numër 1 për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, punësimi dhe mirëqenia tek objektivi lidhur me luftimin e ekonomisë jo-formale, angazhimet përfshinë fushat vijuese: kodi ndërkombëtar telefonik për Kosovën, monitorimin e zbatimit marrëveshjes për të hyrat doganore në dy PPK Jarinjë dhe Bërnjak, kthimin e dosjeve të kadastrës nga Serbia. Për çështjen e kodit telefonik, janë bërë angazhime për tejkalimin e disa pengesave në relacion me dokumentet aplikuese të Austrisë dhe vendimeve të ITU. Janë zhvilluar biseda lobizuese me qeverinë dhe ambasadën austriake, me BE-në dhe Zv/presidenten e PE Ulrike Lunaçek. Marrja e kodit shtetëror do të forcoj subjektivitetin ndërkombëtarë të shtetit dhe krijon të hyra financiare për buxhetin e Kosovës si dhe kontrollin e trafikut telekomunikues.

Kemi monitoruar zbatimin e marrëveshjes për të hyrat nga doganat në PKK Jarinjë dhe Bërnjak nga ku tashmë janë realizuar të hyra në fondin për Zhvillim mbi 5 milion euro si dhe është angazhuar që nga 1 janari 2015 të hyjë në fuqi sipas marrëveshjes regjimi i ri i licencave.

Për çështjet kadastrale jemi kujdesur për miratimin e projektligjit për AKKVP nga ana e qeverisë dhe tani jemi të angazhuar që Kuvendi ta miratoj. Janë bërë presione që pala serbe ti kryej obligimet e saja.

Për regjistrat civil, që tashmë janë kthyer në Kosovë, kemi kërkuar nga ARC të shpejtoj digitalizimin e tyre sepse është një prej kushteve të BE-së për liberalizimin e vizave. Përmes këtij projekti janë hapur edhe 115 vende të reja të punës për një afat kohor një vjeçare.

/fund/